

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

27.02.2025

Ora 15:13

**RENDI I DITËS**

**Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 3, depozituar nga qendra “Qëndresa Qytetare” me objekt “Shfuqizimi i vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin ne Kryeministri. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako (online), z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z. K. Bele, z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, znj. B. Ereqi
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Përfaqësues të Kryeministrit, Qendra “Qëndresa Qytetare”

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr. 3, të depozituar në KQZ me datë 21.02.2025, me ankues qendra “Qëndresa Qytetare”. Objekt i ankimit është vendimmarrja e Komisionerit me nr. 129, datë 20.02.2025 dhe në seancë paraprake është vendosur që të kalonte pjesërisht për shqyrtim kjo kërkesë ankimore, vetëm sa i përket pikës së parë të saj, që kishte të bënte pikërisht me shfuqizimin e vendimit nr. 129, të datës 20.02.2025. E pranishme është trupa e KAS-it, me pesë anëtarë, njëri nga anëtarët, anëtari Elvin Lako është i lidhur online dhe në bazë të rregullores KAS-it, në këto kushte quhet që përbërja e KAS-it është e plotë. Po ashtu i pranishëm është përfaqësuesi i “Qëndresës Qytetare”, vetëm për efekt procesverbali ju lutem.

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Dhimitër Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”.


**Z. L. Braho:** Përfaqësuesja e Kryeministrit!

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Madalena Koja, përfaqësuese me autorizim.

**Z. L. Braho:** Në lidhje me Bashkinë e Tiranës është njoftuar për seancën paraprake, por edhe për seancën e sotme, kanë marrë dijeni dhe nuk ka përfaqësues për sa i përket Bashkisë së Tiranës, kështu që në këto kushte do të vijojë shqyrtimi administrativ në mungesën e tyre. Atëherë shkurtimisht ia japim fjalën si fillim ankuesit në lidhje me pretendimet e tij, vetëm ju lutem fokusohuni vetëm për atë që ka kaluar për shqyrtim administrativ, pra në lidhje me shkaqet që ju pretendoni shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Faleminderit të nderuar! Për sa i takon shkaqeve që ne pretendojmë në lidhje me shfuqizimin e vendimit nr.129, të datës 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhen kryesisht me faktin që në datën 20 shkurt, Kryeministria ka zhvilluar një aktivitet, veprimtari publike, takim me punonjësit e Bashkisë së Tiranës, ky është fakt i provuar tani sepse ka video regjistrime dhe në të njëjtën kohë “Qëndresa Qytetare” ka vendosur në dispozicion për këtë takim të gjitha provat përkatëse. Nga verifikimi që “Qëndresa Qytetare” në të njëjtën ditë ka bërë në faqen NRI të raportimeve ka rezultuar që nuk ka asnjë lloj raportimi mbi këtë veprimtari publike. Në të tilla kushte ne i jemi drejtuar Komisionerit për të konstatuar ose më saktë për të ndaluar këtë veprimtari, duke

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

qenë se ishte një veprimtari e paraportuar. Nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, megjithëse nga ana jonë është saktësuar se nuk kemi të bëjmë veprimtarinë që pretendohet nga ana e Kryeministrit se raportohet, që është një veprimtari e titulluar ceremonia e hapjes “Tirana Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut”. Sërish Komisioneri ka refuzuar këto qëndrime të “Qëndresës Qytetare” dhe provat që ne i kemi vënë në dispozicion duke pretenduar se Kryeministria ka ndryshuar veprimtarinë, adresën po edhe orarin e zhvillimit të këtyre veprimtarive, ndërkohë që në referim të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator është e ndaluar që të kryhet modifikimi dhe ndryshimi i të dhënave të veprimtarive publike të raportuara, pra mbi Kryeministrinë ka rezultuar, më saktë ka rënë detyrimi për të raportuar sërish një veprimtari publike, gjë që nuk e ka bërë në asnjë moment, duke qenë edhe jashtë afatit. Në të tilla kushte duke qenë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka refuzuar kërkesën tonë për të ndaluar këtë veprimtari, i jemi drejtuar KAS-it për të konstatuar paligjshmërinë e këtij vendimi sepse kemi të bëjmë me dy veprimtari të ndryshme. Veprimtaria që pretendon Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është një veprimtari që bëhet pa pjesëmarrës të rrethit të gjerë duke nënkuptuar këtu një publik të pacaktuar, por përbëhet nga disa pjesëmarrës të caktuar që mund të ketë qenë Ambasadori i Egjiptit apo pjesëmarrës të tjerë, vendi i takimit ishte Teatri i Operas dhe Baletit, ndërkohë që vendi ku është zhvilluar veprimtaria publike e takimit të Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë së Tiranës është sheshi “Skënderbej”. Të dy veprimtaritë kanë pasur qëllime të ndryshme, ndërsa njëra lidhet me një aktivitet ku Bashkia e Tiranës ka fituar le të themi një titull ose do të mbajë për këtë vit një titull siç është “Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut”. Veprimtaria tjetër ka qenë një veprimtari krejtësisht e një natyre të ndryshme, ku ka pasur edhe komunikime politike dhe Kryeministri ka marrë “de facto” në kundërshtimin tonë rolin e kryetarit të bashkisë duke ushtruar

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

kompetenca e tij e duke folur për punët e mira që Partia Socialiste, Bashkia e Tiranës kishin kryer. Në këtë kontekst, duke qenë se kemi të bëjmë me një veprimtari publike në këndvështrimin tonë ne jemi drejtuar KAS-it me këtë kërkesë për ta shfuqizuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Fjala për përfaqësuesen e Kryeministrit. Ju lutem na sqaroni në lidhje me atë se ç'ka pretendon ankuesi, ai është thelbi i hetimit administrativ. Bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet? Janë aktivitete të ndryshme? Është i raportuar, është i paraportuar? Në qoftë se keni dijeni, çfarë raporti ka ky aktivitet me një institucion tjetër, në rastin konkret Bashkia Tiranë, për të qenë më të saktë?

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Përshëndetje! Atëherë pasi jemi njohur me kërkesën ankimore nr. 3 dhe pas vendimmarrjes së KAS në seancën paraprahe, për pranimin e pjesshëm të ankimit ne prapësojmë si vijon: me datën 14 shkurt 2025, personi përgjegjës për raportimet në institucion në Kryeministrit ka raportuar në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, dy veprimtari, njëra prej të cilave është ceremonia e hapjes së “Tirana Kryeqytet Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”, në këtë ceremoni janë të ftuar të marrin pjesë autoritetet vendase dhe të huaja, ceremoni në të cilën do të jetë i pranishëm si i ftuar edhe Kryeministri i vendit, z. Edi Rama. Veprimtaria është raportuar në datën 14 shkurt për t’u zhvilluar në datën 20 shkurt, në orën 16.00, vendodhja e veprimtarisë Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, njësia administrative nr. 2 në Tiranë. Në datën 19 shkurt, personi përgjegjës për raportimet e veprimtarive publike në Kryeministri ka njoftuar me email KQZ-në se veprimtaria publike, ceremonia e hapjes “Tirana Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”, për shkak të afërsisë me datën e zhvillimit do të ishte e pamundur të bëhej ndryshimi në sistem i

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025**

vendit ku do të organizohet aktiviteti, kështu që nga Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, veprimtaria do të zhvillohet në sheshin “Skënderbej”, aty pranë në orën 16.30, po në njësinë administrative nr.2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi e ka administruar kërkesën e organizatës qendra “Qëndresa Qytetare”, me vendimin nr. 129, datë 20.02.2025 ka vendosur mospranimin e kërkesës për ndalimin e veprimtarisë publike. Në vijim të kërkesës ankimore të paraqitur në seancë nga ana e “Qëndresës Qytetare” ne argumentojmë se ajo nuk është e bazuar ligjërisht, pasi ajo kundërshton vendimin e Komisionerit për lejimin e këtij aktiviteti në rrethana “ekspost”. Ankimi i “Qëndresës Qytetare” nuk mund të mbështetet mbi një interpretim të rregulluar, të rregullave sesa i vetë Komisionerit, i cili ka kompetencë për të vlerësuar të tilla situata. Konkretisht neni 92 i Kodit Zgjedhor parashikon se rastet kur KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të të tretëve konstaton nga informacioni se veprimtaria mund të bëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj dhe ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimit në pjesën që i takon veprimtarisë. Kjo normë ka një natyrë parandaluese dhe synon të shmangë keqpërdorimin e burimeve publike për qëllime elektorale përpara se të zhvillohet një aktivitet i tillë, duke vendosur shënimin në platformën online të raportimit. Në rastin që është objekt diskutimi KQZ ka pasur mundësinë ligjore për të ndaluar aktivitetin përpara zhvillimit të tij por nuk e ka bërë këtë. Në këtë rast nuk ka një provë konkrete që aktiviteti përbën keqpërdorim të burimeve shtetërore për sa kohë ai është raportuar brenda afateve të KQZ-së dhe KQZ-ja nuk e ka ndaluar atë paraprakisht. Lidhur me procedurën e ndjekur vlerësojmë se raportimi është kryer brenda afatit ligjor, pesë ditë përpara zhvillimit të tij, sikundër edhe është cilësuar në raportim Kryeministri është në cilësinë e të ftuarit dhe nuk është Kryeministria organi publik, i cili e organizon aktivitetin. Në funksion të bërjes transparencë për veprimtarinë

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

publike, personi përgjegjës për raportimin ka njoftuar menjëherë KQZ-në për ndryshimin që i është komunikuar të vendndodhjes të zhvillimit dhe të orës. Ajo që vlerësojmë është se aktiviteti është raportuar, publiku është informuar, ashtu sikundër palët e interesuara për të vlerësuar se ky aktivitet është zhvilluar në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor, pra në keqpërdorim të burimeve shtetërore. Ndryshimi i vendndodhjes së zhvillimit të aktivitetit nuk përbën një shkelje ligjore, pasi aktiviteti është raportuar brenda afateve dhe ka qenë transparent, Kryeministria edhe pse në cilësinë e institucionit të ftuar ka njoftuar KQZ-së për ndryshimin e vendit të zhvillimit të aktivitetit dhe ka marrë paraprakisht miratimin e saj. Nuk ka një dispozitë në Kodin Zgjedhor apo vendimin e Komisionit Rregullator që konsideron një ndryshim të tillë si shkelje apo automatike, apo arsye për ndalimin e aktivitetit. Ne bazuar në këto argumente mendojmë që ankimi i “Qëndresës” duhet të rrëzohet, pasi dispozita ligjore parashikon qartë ndalimin e një aktiviteti përpara zhvillimit të tij dhe jo pas zhvillimit të tij. KQZ-ja ka pasur mundësinë, sikundër u theksua më lart, të ndalojë aktivitetin por nuk e ka bërë gjë, ndaj nuk mund të veprojë me efekt prapaveprues për ta cilësuar atë si të ndaluar pas zhvillimit. Gjithashtu nuk ka prova konkrete për keqpërdorim të burimeve shtetërore ndaj pretendimi për ndalimin e aktivitetit është i pabazuar në ligj. Ne kemi depozituar dhe në shkrim prapësimet tona që janë administruar nga administrata e KQZ-së. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Përpara se të kalojmë te pyetjet, fjala është për përfaqësuesen e KQZ-së. Një sqarim edhe për ju paraprakisht, pra të arrini të na arsyetoni që aktiviteti i raportuar, gjithmonë në qasjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, aktiviteti i raportuar nga Kryeministria është i njëjtë me aktivitetin që është zhvilluar atë ditë me 30 minuta vonesë dhe spostimin e vendndodhjes dhe çfarë

*Zbardhi materialin audio  
Adriqna DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.02.2025*

provash janë vënë në dispozicion Komisionerit kur ka zhvilluar seancën sa i përket denoncimit nga “Qëndresa Qytetare”, pra “Qëndresa” ka denoncuar këtë aktivitetin me drejtorin ekzekutiv të një fondacioni dhe me një ambasador apo ka denoncuar se po zhvillohet një aktivitet i ndryshëm nga ky.

**Znj. I. Osmanaj:** Faleminderit! Atëherë në datën 20.02.2025, duam të saktësojmë që nuk kemi administruar një denoncim, po një kërkesë të bërë nga organizata “Qëndresa Qytetare”. Kjo kërkesë është depozituar nëpërmjet adresës së postës elektronike, me një pretendim si më poshtë vijon: në datën 20.02.2025 është njoftuar “Qëndresa Qytetare” përmes platformës të komunikimit elektronik dhe të mediave të ndryshme se në po të njëjtën datë, në orën 16.30, Kryeministri do të zhvillojë një takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë. Të dhënat e parashikuara tregojnë se në këtë takim do të marrë pjesë në mënyrë të organizuar dhe të detyruar e gjithë administrata e bashkisë dhe secili prej drejtorëve apo institucioneve në varësi të saj të mbajë përgjegjësi për vërtetësinë e numrit të stafit dhe të pranishmëve. Në kushtet kur veprimtaria e cituar më sipër sipas të dhënave që disponojmë, pra pretendimet e “Qëndresës” deri më tani pretendohet si një veprimtari me karakter publik që do të organizohet nga Kryeministri dhe që do të zhvillohet në periudhën katër muaj përpara datës së zgjedhjeve. Menjëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pas administrimit të kësaj kërkesë, e cila nuk kishte prova bashkëlidhur, përveçse linkut, një link i cili ishte e vendosur në faqen e parë të kësaj kërkesë, vijoi hetimin administrativ, por jo në seancë publike, duke qenë se afatet ishin të ngushta për të zhvilluar një seancë të tillë publike dhe nga hetimi administrativ rezultoi se në datën 14.02.2025 personi përgjegjës për raportimet në institucionin e Kryeministrit ka raportuar në përputhje me të gjitha afatet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor dy veprimtari me tematikë: inagurimi i Spitalit të Pediatrisë, në Qendrën Spitalore

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

Universitare Tiranë “Nënë Tereza” dhe veprimtarinë, ceremonia e hapjes “Tirana Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”. Sikurse e parashikojnë dhe detyrimet ka cituar të ftuarit që do të marrin pjesë në këtë takim, sikurse edhe datën dhe orën e zhvillimi të kësaj veprimtarie. Në datën 19.02.2025 është administruar një email, i cili bën me dije se ceremonia e hapjes “Tirana Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025” për shkak të afërsisë së eventit, është e pamundur ndryshimi në sistem i vendit ku do të organizohet aktiviteti dhe për këtë arsye vendndodhja do të bëhet nga Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, do të jetë sheshi “Skënderbej” pra në orën 16.30 në po të njëjtin njësi administrative. Nga vlerësimi paraprak i tematikave të veprimtarive të raportuara nga institucioni i Kryeministrit për të dyja këto veprimtari është vlerësuar se nuk hyjnë në fushën e veprimtarive të ndaluara të parashikuara nga neni 92 i Kodit Zgjedhor si dhe vendimi nr. 9 i 2020, i Komisionit Rregullator, të ndryshuar. Pra të dyja veprimtaritë janë veprimtari që janë raportuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe për rrjedhojë nuk ka vend për ndalimin e secilës prej këtyre veprimtarive. Në këto kushte Komisioneri vendosi mospranimin e kërkesës së organizatës “Qëndresa Qytetare” për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Tani te provat që ka bashkëlidhur kërkesës ankimore të “Qëndresës Qytetare” shoh që ka dhe një email që është kjo. Kjo besoj që është fillesa e “Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike” apo jo? Që është një email i orës 13:19, të datës 20. Te kopja që kemi ne këtu të printuar konsultojmë dy dokumenta bashkëlidhur emailit. I kemi këto dokumenta?

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Po i nderuar!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Z. L. Braho:** Pra që është “Kërkesë urgjente” besoj duhet të jetë kërkesa edhe një...

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Nuk e di nëse kërkesa...

**Z. L. Braho:** ...dokument tjetër që është “Aktivitete”.

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Nuk e di nëse kërkesa gjendet bashkëlidhur në fakt, po për sa i takon provës numër 2 që i referohet kërkesa, “Aktivitete aktive” është shkarkuar nga faqja e KQZ-së, është kjo provë me këtë përmbajtje, një tabelë “exeli” numër 1. Po, është shkarkuar nga faqja e KQZ-së ku kemi vënë re se Kryeministria atë ditë do të zhvillonte dy aktivitete bëhet fjalë për aktivitetin numër 3, 20.02.2025, ora 16.00. Lloji i veprimtarisë tjetër, tematika “Kulturë”, institucioni i Kryeministrit. Në të njëjtën kohë vetëm rreth, ndoshta me diferencë 15 minuta pas të njëjtit email, ne ia kemi ribërë dhe njëherë të qartë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve se aktiviteti i denoncuar nuk është i njëjti me veprimtarinë publike të raportuar me titullin “Bashkia e Tiranës organizon ditën e enjte 20.02.2025, ceremoninë e hapjes” etj., kjo pasi adresa e veprimtarisë së raportuar është Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit dhe folësit kryesorë janë përcaktuar, ndërsa nuk pritet që të ketë pjesëmarrës të tjerë sipas shënimit përkatës. Ndërkohë që rezultojnë nga të gjitha mediat dhe të dhënat publike që aktiviteti i orës 16.00 do të ishte aktivitet i hapur për punonjës të Bashkisë dhe në të njëjtën kohë dhe kërkesës ne i kemi, ndoshta nuk i kemi vendosur, printimin e të gjitha ëbsiteve dhe lajmeve, ku gjendej si lajm, por në dijeninë time rezultojnë më shumë se 5 linke nga sa mund të verifikoj unë tani që janë media, burime të njohura “Euronews”, “Balkanweb” etj., që janë burime faktike nga mund të merrej informacioni dhe mund të verifikohet ndoshta dhe vërtetësia e përmbajtjes të denoncimit tonë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

**Z. I. Rusmali:** Për përfaqësuesin e “Qëndresës”, ju keni kërkuar në datën 20 që Komisioneri të ndalonte zhvillimin e kësaj veprimtarie. Çfarë prisnit ju konkretisht që bënte Komisioneri në përgjigje të kësaj kërkesë?

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Të kryente një hetim, së pari të kërkonte një hetim të thelluar dhe tek rezultati të ndalonte veprimtarinë publike sepse kemi të bëjmë me një veprimtari që nuk ishte e raportuar.

**Z. I. Rusmali:** Në ç’formë duhet ta ndalonte?

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Të merrte një vendim për ndalimin e veprimtarisë publike siç ka marrë në raste të tjera.

**Z. I. Rusmali:** Kërkesa juaj mbështetet në precedentin e Komisionerit, referencë ligjore ka?

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Mbështetet në precedentin e krijuar nga Komisioneri bazuar në nenin 92 të Kodit Zgjedhor.

**Z. I. Rusmali:** Neni 92 i Kodit Zgjedhor, dakord. Një pyetje për administratën, kërkesa ka ardhur në datën 20, në aktet nënligjore që ju keni në fuqi për trajtimin e çështjeve të kësaj natyre, përcaktohet që nuk pranohen kërkesa të tilla kur ato bëhen

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.02.2025*

në afatin përtej tre ditëve përpara datës së planifikuar për zhvillim. Kjo është përtej këtij afati, pse e keni pranuar ju për shqyrtim?

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë ne administrojmë çdo denoncim dhe çdo ankim që mund të bëhet nga cdo subjekt zgjedhor, OJF apo çdo palë e interesuar. Në këto kushte një kërkesë të tillë nuk mund ta refuzonim.

**Z. I. Rusmali:** Po pse Rregullatori ka thënë që kjo nuk pranohet, nuk pranohet do të thotë refuzohet, tre ditë, kërkesat që vinë me këtë objekt, që të mos kemi keqkuptime, kërkesat që vinë me objektin e ndërfaqes së raportimeve. Këto kërkesa në qoftë se vinë përtej afatit tre ditor Rregullatori i ka konsideruar të pamundura për t'u trajtuar sepse afati është i shkurtër dhe këto refuzohen. Kush ka për të thënë të flasë para se të "martohen njerëzit", kur "martohen" ka ikur çështja! Pse e keni bërë? Kur kemi rregullat që ua ndalojnë këtë gjë, e keni bërë për "bonsens"? Dakord.

**Znj. I. Osmanaj:** Ne i administrojmë gjithmonë.

**Z. I. Rusmali:** Një pyetje për përfaqësuesen e Kryeministrisë. Po të njëjtat rregulla përcaktojnë që ndryshime të aktiviteteve të planifikuara për t'u zhvilluar nuk mund të raportohen, ndryshime nuk mund të raportohen pasi të kalojë, përtej afatit pesë ditor, pas pesë ditëve, domethënë në harkun midis pesë ditëve të datës së zgjedhjeve dhe të datës së aktivitetit nuk mund të ketë ndryshime, nuk mund të raportohen ndryshime, nuk quhen, nuk njihen, nuk pranohen. Ju keni bërë, personi përgjegjës ka bërë ndryshime në datë 19 ose 20?

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrisë:** Në datën 19 ka njoftuar.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Ka njoftuar. Pse mendoni që kjo duhet të jetë e vlefshme për KQZ-në për t'u pranuar, kur ajo është përtej rregullave të përcaktuara nga Rregullatori?

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Më lejoni të sjell dhe njëherë në vëmendje që ndryshimi nuk konsiston në datën e zhvillimit të veprimtarisë, është po data 20 e raportuar, pra afati pesë ditor është tërësisht i respektuar, ka ndryshuar vetëm vendndodhja, pra nga Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit në sheshin “Skënderbej”, pra në të njëjtën hapësirë pak a shumë dhe ndryshimi i orës, nga 16.00 në 16.30. Dëshiroj pra të sjell në vëmendje që raportimi nuk mund të modifikohet edhe për elementë teknike siç është rasti konkret në ndërfaqe dhe kjo është e vërtetë, por mesa duket qëllimi është respektuar, pra bërja transparente e ndryshimit të vendndodhjes nëpërmjet këtij ndryshimi teknik që është bërë nëpërmjet emailit nga ana e personit përgjegjës për raportimet, ka pasur si qëllim bërjen transparente dhe njoftimin e publikut. Pra bëhet fjalë vetëm për ndryshim të vendndodhjes dhe spostim të orarit me 30 minuta, jo datë të ndryshimit të veprimtarisë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Vendimi i Komisionit Rregullator e lejon ndryshimin e vendndodhjes përtej afatit pesë ditor apo?

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Portali nuk lejon të bësh ndryshime.

**Z. I. Rusmali:** Portali nuk e lejon sepse vendimi i Rregullatorit e ka ndaluar apo jo, apo është arbitrar portali?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Në rastin konkret, sikundër Kodi Zgjedhor dhe vendimi 9 i cili padyshim del në bazë dhe për zbatim të tij thekson si element afatin pesë ditor. Është shumë i rëndësishëm respektimi i afatit sepse kjo bën të mundur transparencën me palët e treta dhe publikun dhe i jep mundësinë KQZ-së për të vendosur ndalimin në rastet që Kodi parashikon sikundër është keqpërdorimi i fondeve shtetërore në një aktivitet publik. Në rastin konkret nuk ndryshohet data, as tematika, ndryshohet vetëm vendndodhja dhe nëse të gjithë e kemi parasysh bëhet fjalë për Teatrin e Operas dhe përballë kemi sheshin “Skënderbej” dhe spostimi i orës vetëm me 30 minuta.

**Z. I. Rusmali:** Unë nuk dua ta bëj debat se s’ka vend për debat këtu, unë dua të di vetëm, ju në bindjen tuaj ndryshimi i këtij elementi të aktivitetit ka qenë në përputhje me vendimin e Rregullatorit apo jo? Kaq.

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Ne mendojmë që ndryshimi është në përputhje me afatet e përcaktuara.

**Z. I. Rusmali:** Edhe njëherë tek “Qëndresa”. Kodi ka besoj unë, mjaftueshëm qartë, ka trajtuar dy koncepte, konceptin e veprimtarive të ndaluara për shkak të ligjit, Kodi i ndalon, një grup veprimtarish që të zhvillohen gjatë një periudhe të caktuar dhe veprimtarive të ndaluara nga Komisioneri për shkak të detyrës, është një gjë tjetër. Vendimi numër 9 trajton jep procedurën sesi Komisioneri ndalon veprimtaritë. Kjo procedurë ka parakusht raportimin e veprimtarisë, pra ndalon nëpërmjet spostimit, në faqe veprimtari e ndaluar, po në fakt në faqe për veprimtarinë e raportuar, jo për një veprimtari të paraportuar. Tani ju jeni vënë në lëvizje me arsyetimin, veprimtaria është e paraportuar por keni kërkuar nga Komisioneri që ta ndalojë veprimtarinë, si

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.02.2025*

ta bëj këtë, e zgjidhni dot këtë lloj kontradikte? Ai ndalon vetëm veprimtaritë e raportuara, jo të paraportuara, tani për ju është veprimtari e raportuar që duhet të ndalohej apo është veprimtari e paraportuar që duhet të ndëshkohej?

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Atëherë për ne është veprimtari e paraportuar, jo vetëm për ne por provat në fakt, është veprimtari e paraportuar dhe duhet të sanksionohet vetë edhe duke ndërmarrë masën e ndalimit po duhet të sanksionoheshin të gjithë personat përgjegjës që po merrnin pjesë me organizimin e veprimtarisë. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për përfaqësuesen e Kryeministrit, tani ndodhemi pas zhvillimit të aktivitetit, ju si Kryeministri, nuk po flas për ju personalisht, i qëndroni ende faktit që aktiviteti është ky i raportuari, ai që ka ndodhur atë ditë në sheshin “Skënderbej”? Pra ky me ambasadorë dhe pa pjesëmarrje, veprimtaria nuk ka pjesëmarrës të tjerë, ky është si është raportuar, pra i qëndroni këtij pretendimi, që është ky aktiviteti me 5 persona dhe pa pjesëmarrës apo është një aktivitet i ndryshëm nga ai?

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Është aktiviteti i raportuar, të cilin institucioni i Kryeministrit e ka raportuar në funksion të bërjes transparente të veprimtarisë publike Kryeministrit, në cilësinë e personit të ftuar në këtë aktivitet.

**Z. L. Braho:** Mirë, një pyetje tjetër, po nga faktet e njohura botërisht a ka pasur dhe një aktivitet tjetër po në të njëjtën ditë, po në të njëjtën orë Kryeministri me administratën e Bashkisë Tiranë?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Kryeministri ka marrë pjesë i ftuar në atë aktivitet që është raportuar në ndërfaqen e raportimeve në KQZ.

**Z. L. Braho:** Dakord, nuk kam pyetje të tjera. Për përfaqësuesen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga informacionet tuaja është i njëjti aktivitet, ai që nuk ka ndaluar Komisioneri me atë që ka ndodhur dhe në qoftë se ka ndonjë denoncim tjetër në lidhje me këtë fakt, pasi ka ndodhur aktiviteti?

**Znj. I. Osmanaj:** Ne kemi administruar edhe një denoncim tjetër nga Partia Demokratike në lidhje me këtë aktivitet, aktualisht jemi në fazën e hetimit administrativ. Nuk ka ende një vendimmarrje, pra ende nuk është bërë dhe seanca paraprake që të pyeten palët në lidhje me këtë, ndërsa nga ajo që vlerësojmë dhe gjykojmë kemi të bëjmë me dy aktivitete të ndryshme, një aktivitet është ky që është raportuar nga Kryeministria dhe aktiviteti tjetër është ai që nuk është raportuar por nga faktet të njohura botërisht rezulton që është aktiviteti i zhvilluar në sheshin “Skënderbej” dhe në po të njëjtën orë që përkon me orën e raportimit të veprimtarisë publike.

**Z. L. Braho:** Dakord. Unë nuk kam pyetje të tjera.

**Z. I. Rusmali:** Kam unë një pyetje.

**Z. L. Braho:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Përfaqësuesja e Kryeministrit tha që organizator i aktivitetit ishte Bashkia e Tiranës, në vlerësimin tuaj kush ishte organizator i aktivitetit?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Në vlerësimin tonë edhe referuar faqes së Kryeministrit vetë, të cilën e kemi vendosur në fakt në dispozicion si lidhje bëhet fjalë me zhvillimin e këtij aktiviteti nga ana e Kryeministrit Edi Rama, pra nga ana e Kryeministrit është, po e nis me fjalën “Kryeministri Edi Rama zhvilloi sot një takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë në sheshin “Skënderbej”, etj., etj., dhe Kryeministria edhe në mënyrën e transmetimit ose në transmetimin e videos live ka marrë përgjegjësinë mbi organizimin e këtij aktiviteti dhe bëhet fjalë për Bashkinë e Tiranës.

**Z. I. Rusmali:** Në pretendimet tuaja ju thatë që organizator ishte Bashkia e Tiranës, sipas rregullave në fuqi detyrimin për raportim e ka institucioni organizator, pse keni ndjerë ju nevojën që të raportoni?

**Znj. M. Koja, përfaqësuese e Kryeministrit:** Faleminderit për pyetjen! Në fakt deri në datën e sotme që flasim institucioni i Kryeministrit ka bërë disa raportime në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nëse do të bënim një “check” në të gjitha këto veprimtari Kryeministri ka qenë i ftuar, në cilësinë e të ftuarit. Kjo është një zgjedhje e institucionit për të bërë transparencë mbi aktivitetin e Kryeministrit në rastin konkret.

**Z. I. Rusmali:** Një pyetje për administratën në të njëjtën linjë. Çfarë vlere kanë për ju këto raportimet e pakërkuara?

**Znj. I. Osmanaj:** Sikurse citohet edhe nga vendimi 9 i Rregullatorit detyrimi për raportim qëndron mbi institucionin organizator, në rast se konstatohet që një veprimtari ka dy bashkëorganizator atëherë ka detyrë secili institucion ka detyrimin

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.02.2025*

për ta raportuar. Ne marrim në shqyrtim dhe në hetim administrativ institucionin organizator të veprimtarisë publike.

**Z. I. Rusmali:** Po në qoftë se qëllon, gjithsesi që një institucion mbi baza vullnetare bën më shumë se ç'i kërkon ligji, çfarë vlere juridike ka për ju? Domethënë në qoftë se ky raportim i pakërkuar nga ligji nuk është i rregullt, ka difekte, ka probleme, modifikohet rrugës në mënyrë të, jo në përputhje me ligjin ndëshkohet personi përgjegjës për raportimin?

**Znj. I. Osmanaj:** Jo, s'ka asnjë efekt ligjor.

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Z. K. Bele:** Pak a shumë dhe unë nuk e kuptoj, se kjo pjesa e raportimit është pak komplekse. Një aktivitet mund të jetë Kryeministri dhe dy-tre ministra, ndoshta Kryetari i Kuvendit, çfarë kuptimi ka që të raportojnë ata të dhjetë, apo të pestë, apo tre, nuk ka një orientim apo një lloj frenimi nga ana juaj sepse ne kuptojmë që KQZ-ja ka shumë ngarkesë, nga ana tjetër shikojmë një lloj teprie në raportime, merren me riskun e pasaktwsiw, përgjegjësi po ndoshta dhe në këtë rast, nuk ka ndonjë lloj?

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë ka një sistem i cili gjeneron automatikisht çdo raportim që bëhet nga institucionet publike, nuk është se i ndalohe dot nëse është në cilësinë e të ftuarit, t'i ndalohe nga sistemi për mosraportimin e kësaj veprimtarie publike, pra institucionet janë të lirë të raportojnë çdo veprimtari por detyrimi i tyre është të raportojnë ato veprimtari publike për të cilat ata janë organizator, jo të ftuar.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Z. K. Bele:** Tjetër që ndoshta është e përgjithshme po më ndihmon të kuptoj se me ç' duket do të kemi raste të tilla plot. Nga denoncimet që vinë nga shoqëria apo aktorë të shoqërisë civile ka një minimum formati, pra nëse institucionet si dhe një format, ka një format të caktuar dokument bashkëlidhur, një format me disa apo pranohen edhe thjesht një email?

**Znj. I. Osmanaj:** Administrimi i denoncimeve, për administrimin e denoncimeve ka porta të ndryshme hyrëse, domethënë ne administrojmë denoncimet që vinë në protokoll, administrojmë denoncimet që vinë nga portali, është një pikë e dedikuar që automatikisht gjeneron të gjitha denoncimet që mund të bëhet nga çdo palë e interesuar dhe e cwnuar për këtë proces, gjithashtu mund të vinë edhe nëpërmjet adresës...Në rast se duan të ngelen sinjalizues, kjo merret për bazë nga ana jonë. Gjithashtu mund të vinë edhe në adresën e emailit që është kqz.gov.al dhe mund të vinë te Koordinatori i të Drejtës për Informim dhe nuk është se janë të përcaktuara me detyrim çdo provë ose çdo informacion i detyruar...

**Z. K. Bele:** Kuptoj s'ka një minimum formati, mjafton që dikush të çojë një rresht në KQZ konsiderohet denoncim. Dakord,mirë, faleminderit!

**Znj. I. Osmanaj:** Jo. Ne i administrojmë të gjitha këto.

**Z. L. Braho:** Në cilësinë e provës është administruar në ndonjë nga palët ndonjë ftesë për këto aktivitete? Pra që të rezultojë formalisht kush është organizatori?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 27.02.2025*

**Znj. I. Osmanaj:** Është bërë komunikim elektronik, sikurse dhe me përfaqësuesin e Bashkisë Tiranë për të dhënë informacione shtesë në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi sot, deri tani nuk kemi administruar asnjë email në lidhje me këtë çështje, qoftë ftesë apo prapësime në lidhje me këtë hetim.

**Z. L. Braho:** Jo, flas për këtë të raportuarin njëherë.

**Znj. I. Osmanaj:** Jo.

**Z. L. Braho:** S'ka ndonjë ftesë që ta ketë organizuar Bashkia Tiranë, ndërkohë që për aktivitetin që dhe ju e pranuat që është tjetër, nuk ka raportim as nga Bashkia Tiranë, pra që të jetë ai organizatori?

**Znj. I. Osmanaj:** Jo.

**Z. L. Braho:** Dakord. Mirë, atëherë përfundimisht ankuesi i “Qëndresës Qytetare” çfarë kërkon nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve?

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Shfuqizimin e vendimit numër 129, të 2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me qëllim që të vijojë mundësia pastaj për sanksionimin e personave përgjegjës duke i kërkuar Komisionerit propozimin e masës administrative.

**Z. L. Braho:** Pra ju kërkonte që KAS ta konsiderojë aktivitetin, aktivitet të ndaluar apo aktivitet të paraportuar dhe nga kush, nga Kryeministria, nga Bashkia?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025*

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”:** Nga ana e KAS-it ne kërkojmë kjo veprimtari të konsiderohet si një veprimtari e paraportuar sepse nuk kemi të bëjmë me të njëjtën veprimtari dhe persona përgjegjës, sikundërse është Kryeministria.

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Përfaqësuesja e Kryeministrisë, ju përfundimisht?

**Znj. M. Koja:** Në përfundim të shqyrtimit ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës ankimore si të pabazuar në ligj dhe në prova, për argumentet e parashtruara më lart. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Po Komisioneri?

**Znj. I. Osmanaj:** Kërkojmë lënien në fuqi të vendimit nr. 129, datë 20.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Z. L. Braho:** Mirë, faleminderit! Do të tërhiqemi për vendim, zoti Lako nuk ka pyetje. Dakord. Atëherë do të tërhiqemi për vendim për 30 minuta, pra në ora 16.20 do të shpallim vendimin. Faleminderit!

**Rifillon seanca**

**Ora 16:33**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje edhe njëherë! KAS pasi u tërhoq për vendim në lidhje me kërkesën ankimore nr. 3, datë 21.02.2025 të paraqitur në KQZ nga qendra “Qëndresa

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 27.02.2025***

Qytetare”, në zbatim të nenit 143, pika 1, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor duke qenë se aktiviteti i zhvilluar në datë 20.02.2025, ora 16.30 në sheshin “Skënderbej” është aktivitet i ndryshëm nga ai që është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, vendosi: Shfuqizimin e vendimit nr. 129, datë 20.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë brenda 45 ditëve. U shpall sot më datë 27.02.2025. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 9**

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***

